

Vendim nr. 204 datë 30.09.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 30.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 15 (P) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **PRENA MRRUKU**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 122, datë 26.01.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-5092, datë 13.12.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkesja Prena Mrruku ka qenë e punësuar në shoqërinë “Ujësjetllës Kurbin” sh.a. (*UK*), që prej datës 21.02.2002, në detyrën e përgjegjëses të sektorit të financës. Me urdhrin nr. 127 prot., datë 15.08.2007, kërkeses i është dhënë vërejtja për largimin nga detyra me

motivacionin “Për mosdhënie informacioni për të ardhurat dhe shpenzimet për 7-mujorin e vitit 2007”. Kërkuesja ka marrë dijeni për vërejtjen në datën 20.08.2007.

2. Me urdhrin nr. 128 prot., datë 20.08.2007, kërkueses i është komunikuar vendimi i punëdhënësit për largimin e saj nga puna. Duke mos qenë dakord me këtë vendim në datën 19.09.2007 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin me kërkesëpadi me objekt kthimin në vendin e mëparshëm të punës dhe dëmshpërblimin për mosrespektimin e procedurave të largimit nga puna sipas Kodit të Punës.

3. Me urdhrin nr. 166, datë 03.10.2007, kërkuesja është caktuar në pozicionin e arkëtares në sektorin Laç 2, pranë UK-së, duke rinisur marrëdhënien e punës në datën 04.10.2007. Me urdhrin e datës 05.10.2007 të UK-së është urdhëruar kryerja e pagesës së prapambetur ndaj kërkueses për periudhën nga 16.08.2007 deri më 30.09.2007, duke mos e shkëputur marrëdhënien e mëparshme të punës e duke siguruar vazhdimësi me një profil të ri pune. Në datën 15.11.2007 kërkueses i është komunikuar vërejtja për largimin nga puna me motivacionin për “mosmbledhje të ardhurash gjatë tetorit të vitit 2007”.

4. Në vijim, me vendimin nr. 191, datë 22.12.2007 të UK-së, kërkuesja është larguar nga detyra duke u ndërprerë marrëdhënia e punës në datën 24.12.2007.

5. Për sa i përket kërkesëpadisë së kërkueses për kundërshtimin e urdhrin të UK-së nr. 128 prot., datë 20.08.2007, për largimin nga puna, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 482/658, datë 13.12.2007, ka vendosur rrëzimin e saj. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesja. Me vendimin nr. 1073, datë 25.09.2009, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

6. Me vendimin nr. 185-146, datë 11.02.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, detyrimin e UK-së të dëmshpërblejë kërkuesen me gjashtë paga mujore për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës si arkëtare, bazuar në nenin 155, pika 3, të Kodit të Punës, dëmshpërblimin me gjashtë pesëmbëdhjetëditësha pagë për vjetërsi në punë, bazuar në nenin 145 të Kodit të Punës, si dhe dëmshpërblimin me një muaj pagë për mosrespektimin e afatit të njoftimit, sipas nenit 143, pika 1, të po këtij kodi. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim respektivisht, kërkuesja, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e plotë të padisë, si dhe pala e paditur, UK-ja, duke kërkuar rrëzimin e padisë.

7. Me vendimin nr. 122, datë 26.01.2011, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesja.

8. Me vendimin nr. 00-2013-2191, datë 31.10.2013, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur.

9. Në datën 27.05.2015 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë më kërkesë për rishikimin e vendimit civil nr. 185-146, datë 11.02.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, lënë në fuqi me vendimin nr. 122, datë 26.01.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke paraqitur si prova procesverbalet e seancave gjyqësore në gjykimin në shkallë të parë ku, sipas saj, vërehen shkelje serioze procedurale dhe shkesore, me dyshimin se vendimet gjyqësore objekt rishikimi janë marrë bazuar në akte të falsifikuara ose në kushtet e një prove joekzistuese.

10. Me vendimin nr. 00-2023-5092, datë 13.12.2023, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, duke arsyetuar se nga dokumentacioni bashkëlidhur kësaj kërkesë, procesverbalet e seancave gjyqësore të zhvilluara për këtë gjykim dhe nga përmbajtja e tyre, nuk kanë rezultuar rrethana të reja ose prova të reja me shkesë që të kenë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihen nga pala gjatë shqyrtimit të saj. Sipas asaj gjykate, procesverbalet e paraqitura që pretendohen se përbëjnë rast rishikimi nuk i përmbushin kriteret ligjore për t'u konsideruar rrethana ose prova të reja shkesore të zbuluara rishtazi dhe që nuk mund të dihen gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar, sipas nenit 494/a të Kodit të Procedurës Civile (KPC) (*shih paragrafin 13 të vendimit të Kolegjit Civil*).

11. Në datën 21.05.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000 është regjistruar në datën 02.07.2024. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr.8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkueses

12. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi gjykatat e faktit nuk kanë vlerësuar provat dhe faktet e paraqitura në gjykim prej saj, nuk janë

shprehur dhe nuk kanë pranuar provat shkresore të cilat vërtetonin shkaqet e vërteta të largimit të saj nga puna. Për rrjedhojë, edhe Gjykata e Lartë në procesin e rishikimit ka lënë në fuqi vendimmarrjet e mëparshme duke mos pranuar si prova procesverbalet e seancave gjyqësore gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të parë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

13. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

14. Kolegji vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur.

15. Kërkuesja plotëson edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, pasi rezulton se ajo ka kundërshtuar procesin e rishikimit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë për të cilin, duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm dhe vendimi i Gjykatës së Lartë përfundimtar, nuk ka mjet tjetër juridik për të shteruar për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar përveç kërkesës në këtë Gjykatë, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000.

16. Lidhur me legjitimitetin *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji vëren se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka marrë në shqyrtim kërkesën për rishikim, mban datën 13.12.2023, ndërsa ankimi

kushtetues individual është paraqitur në datën 21.05.2024. Nga komunikimi nëpërmjet postës elektronike me Gjykatën e Lartë rezulton se vendimi i rishikimit është publikuar në faqen e saj zyrtare dhe është bërë i disponueshëm për palët në datën 25.03.2024, datë nga e cila ka filluar të ecë afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Për rrjedhojë, ankimi kushtetues individual për kundërshtimin e vendimit të rishikimit të Gjykatës së Lartë është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, ndaj kërkuesja legjitimohet *ratione temporis*.

17. Kolegji vëren, gjithashtu, se kërkuesja, në objektin e ankimit kushtetues individual, ka kundërshtuar edhe vendimin nr. 122, datë 26.01.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë, ndërkohë që në përmbajtje të tij ka ngritur pretendime për të tria vendimet gjyqësore të dhëna në procesin e rigjyimit të çështjes, të cilat kanë shqyrtuar padinë e saj për kthimin në vendin e mëparshëm të punës dhe dëmshpërblimin për mosrespektimin e procedurave të largimit nga puna. Në lidhje me këtë proces rezulton se ai është përmbysur me vendimin nr. 00-2013-2191, datë 31.10.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Kërkuesja, edhe pse i ka pasur të gjitha mundësitë dhe mjetet juridike në dispozicion, sipas parashikimeve dhe afateve ligjore në fuqi në atë kohë, nuk rezulton që të ketë ushtruar këto mjete për të kundërshtuar procesin gjyqësor që ka shqyrtuar në themel padinë e saj. Kolegji vlerëson se kërkesa për rishikim në Gjykatën e Lartë nuk është e tillë që të rivendosë kërkuesen në afatin ligjor të paraqitjes së ankimit kushtetues për kundërshtimin e atyre vendimeve gjyqësore. Për rrjedhojë, në lidhje me kundërshtimin e vendimeve gjyqësore të themelit të çështjes, kërkuesja nuk ka respektuar afatin ligjor për kundërshtimin e tyre ndaj nuk legjitimohet *ratione temporis*.

18. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, ka cenuar të drejtën e saj për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi provat mbi të cilat ajo ka mbështetur kërkesën, konkretisht procesverbalet e seancave gjyqësore gjatë gjyqimit të parë të çështjes në shkallë të parë nuk janë administruar në rigjykim, për rrjedhojë nuk janë marrë në shqyrtim, edhe pse përbëjnë prova të reja në kuptim të nenit 494 të KPC-së.

19. Gjykata, në mënyrë konstante në jurisprudencën e saj ka pohuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi dhe zbatimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjyqimit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes. Ajo nuk

mund të bëjë vlerësim të provave, interpretim të ligjit dhe as të përcaktojë mënyrën e zgjidhjes së çështjes, sepse këto të fundit hyjnë në sferën e kompetencave të gjykatave të sistemit gjyqësor (shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 7, datë 07.02.2017 dhe nr. 13, datë 10.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese).

20. Në këtë kuptim, referuar në tërësi argumenteve të kërkueses për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, Kolegji vlerëson se ato kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave dhe të interpretimit e zbatimit të ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, ndërkohë që ajo nuk ka arritur të paraqesë ndonjë argument kushtetues, pra të provojë cenimin e ardhur në këtë të drejtë kushtetuese për shkak të vendimmarrjes së kundërshtuar të Gjykatës së Lartë. Kolegji vëren se kërkesa për rishikim është marrë në shqyrtim nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, i cili, në përputhje me kompetencat e tij ligjore ka analizuar shkaqet e parashtuara nga kërkuësja, duke i dhënë asaj përgjigje të arsyetuar se nga dokumentacioni bashkëlidhur kërkesës, procesverbaleve të seancave gjyqësore të zhvilluara për këtë gjykim dhe nga përmbajtja e tyre, nuk kanë rezultuar rrethana të reja ose prova të reja me shkresë që të kenë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të diheshin nga pala gjatë shqyrtimit të saj. Po kështu, ajo gjykatë ka vlerësuar se procesverbalet e paraqitura që pretendohen se përbëjnë rast rishikimi nuk i përmbushin kriteret ligjore për t'u konsideruar rrethana ose prova të reja shkresore të zbuluara rishtazi dhe që nuk mund të diheshin gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar, sipas nenit 494/a të KPC-së. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuësja nuk ka arritur të argumentojë nga pikëpamja kushtetuese cenimin e së drejtës për proces të rregullt gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar nga Gjykata e Lartë për shqyrtimin e kërkesës së saj për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

21. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.